



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 24 .03.2014

PËR: **Ramadan Muja, Kryetar i Komunës së Prizrenit**
Lulzim Kabashi, Nënkyetar i Komunës së Prizrenit

LËNDA: Përgjigje ne shkresën e Komunës së Prizrenit lidhur me njoftimin nr.01-52/14 i datës 18.03.2014

Të nderuar

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me datë 21 Mars 2014 ka pranuar kërkesë nga nënkryetari i komunës për dhënien e opinionit ligjor, lidhur me, pezullimin e aktiviteteve nga Kryetari i Komunës deri në shqyrtimin e ankesës nga Gjykata e Apelit, të parashtruar nga kryetari i komunës ndaj vendimit të Gjykatës Themelore në Prizren.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë të përcaktuara me nenin 76 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të kërkesës, pezullimit të aktiviteteve nga kryetari i komunës dhe legjislacionit për vetëqeverisje lokale, jep këtë sqarim:

- Pezullimi i aktiviteteve të kryetarit të komunës së Prizrenit nuk është parapa me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe i njëjti veprim nuk prodhon efekt juridik;
- Deri në vendimin e formës së prerë të Gjykatës kompetente, Kryetari i Komunës së Prizrenit ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë, ashtu siç është parapa me nenin 58 Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet tjera sektoriale;

Nga ajo që u tha më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pret nga kryetari i komunës së Prizrenit të vazhdojë mandatin e tij konform legjislacionit ne fuqi.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së



Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve në MAPL
Arkivit të MAPL-së